



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Aplikacion Plotësues për Tarifa –KEK Furnizimi - Final -

Maj 2007

Prishtinë



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

PËRMBAJTJA

Maj 2007 1

Prishtinë 1

| | | |
|----------|---|----------|
| 1 | Hyrje | 3 |
| 2 | Alokimi i të Hyrave të Lejueshme sipas Kategorive të Konsumatorëve ... | 4 |
| 3 | Struktura Tarifore..... | 6 |



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

1 Hyrje

Me datë 07 Maj 2007, Bordi i ZRrE ka nxjerrë Vendimin Nr. D_47_2007 me të cilin ka vendosur që të marr përsëri në konsideratë vendimin Nr. D_29_2006 lidhur me nivelin e Të Hyrave të Lejueshme për KEK.

Me datë 25 Prill 2007, KEK ka kërkuar nga ZRrE që të shqyrtojë nivelin e Të Hyrave të Lejueshme që do të përfshihen në tarifa si vijon:

| | |
|---|-----------------|
| Të hyrat e Lejueshme të aprovuara me datë 21 Dhjetor 2006 | € 141.9 million |
| Zvoglimet e Propozuara | € 6.9 million |
| Të Hyrat e Lejueshme pas Shqyrtimit | € 135.0 million |

Qëllimi i kësaj shkrese është që të propozojë një strukturë tarifore për secilën kategori të konsumatorëve e cila do t'i mbulojë Të Hyrat e Lejueshme të Reviduara.

Ky aplikacion do të duhej të konsiderohej si një plotësim i aplikacionit origjinal i dorëzuar nga ana e KEK-ut me datë 19 shkurt 2007, në të cilin u ngritën shumë çështje lidhur me strukturën tarifore, në kontekst të angazhimit të KEK-ut që të shëndrrohet në një ndërmarrje të orientuar drejt komercializmit dhe me qëllim të përmirësimit të matjes së energjisë elektrike, faturimit dhe inkasimit të saj. Prandaj, meqë ky Aplikacion Plotësues nuk i adreson çështjet e caktuara sa i përket strukturës tarifore, dhe çështjeve tjera, ZRrE do të duhej të thirret në aplikacionin origjinal të KEK-ut të dorëzuar me datë 19 shkurt 2007.

2 Alokimi i Të Hyrave të Lejueshme sipas Kategorisve të Konsumatorëve

Tarifat duhet të jenë në harmoni me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Metodologjisë së Tarifave, në veqanti me kërkesat për reflektimin e kostove dhe mos-diskriminimin që kërkohet në atë metodologji. Për më tej, kërkohet që të analizohet përcaktimi i ngarkesave të tanishme, në veqanti marrëdhëniet mes ngarkesave përkatëse të kategorive të ndryshme të konsumatorëve dhe kostot e furnizimit të këtyre konsumatorëve.

Tarifat e tanishme të KEK-ut janë aprovuar me 1 korrik 2000 dhe janë llogaritur për një ndërmarrje të integruar pa konsumatorë të privilegjuar. Tarifat e propozuara këtu kryesisht janë bazuar sipas nivelit të tensionit dhe mund të zërthehen në ngarkesën për fuqinë e angazhuar, ngarkesën sipas energjisë aktive dhe ngarkesën sipas energjisë reaktive në tarifa ditore dhe sipas sezonës. (shiko seksionin 4 të këtij aplikacioni).

Pas gjashtë vitesh të strukturës tarifore të pa ndryshuar dhe të pa freskuar me të dhëna të reja, është nevojitur një shqyrtim tarifar me qëllim të përmbushjes së kërkesave nga Metodologjia e re tarifore për Kosovë e nxjerrur nga ana e ZRrE të datës 15 dhjetor 2005.

ZRrE ka zhvilluar një Model Tarifar i cili mund të përdoret për implementimin e Metodologjisë tarifore dhe alokojë Të Hyrat e Lejueshme sipas kategorive të konsumatorëve. ZRrE ka futur Të Hyrat e Lejueshme në model dhe ka përcaktuar që alokimi i duhur sipas kategorive të konsumatorëve (përfshirja e reflektimit të kostove dhe nevojën për zvoglimin e subvencionit mes veti) në vijim:



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

| <u>Kategoria</u> | <u>Të hyrat e lejueshme</u> |
|---------------------------|-----------------------------|
| | (€000) |
| 0 110 KV | 4,424 |
| 1 35 KV | 1,338 |
| 2 10 KV | 9,897 |
| 3 Kons. Komer. Të Mëdhenj | 8,020 |
| 4 Kons. Komer. Të Vegjël | 27,000 |
| 5 Amvisësitë - TOU | 67,274 |
| 6 Amvisëritë - 1 Njehësor | 12,279 |
| 7 Amvisëritë e Pamatura | 3,933 |
| 8 Ndriqimi Publik | 817 |
| TOTAL | 134,982 |

KEK-u e përshëndet atë se ZRrE ka përkushtuar burimet e veta të shumëta në zhvillimin dhe implementimin e këtijë modeli dhe i pranon rezultatet e alokimit të të Hyrave të Lejueshme sipas kategorive të konsumatorëve në harmoni me Metodologjinë Tarifore.

Shumat e lartshënuara janë përdorur për përpilimin e tarifave sipas kategorive siç është përmendur në Seksionin 3.

3 Struktura Tarifore

Me përcaktimin dhe alokimin e të Hyrave të Lejueshme sipas kategorive të konsumatorëve, hapi tjetër është që të përgatitet struktura tarifore e cila do t'i mbulojë keto të hyra.

Për qëllime të transparencës, KEK-u ka përdorur modelin e ZRRë për strukturim të tarifave. Kjo mundëson mbajtjen ndaras të kostove nga ana e klasës tarifore dhe i mundëson Bordit që me lehtësi të provojë se në ç'formë janë mbuluar kostot.

Metodologjia Tarifore dhe Rregula për Caktimin e Çmimeve sqarojnë përcaktimin e të Hyrave të Lejueshme nga ana e një aktiviteti të licencuar (shthurrur) dhe mënyrën se si të Hyrat e Lejueshme do të shpërndahen sipas kategorive të konsumatorëve me qëllim që të reflektojnë kostot dhe minimizojnë subvencionet mes veti. Megjithatë ka pak udhëzime sa i përket përgatitjes së tarifave individuale (komponentja e fuqisë angazhuese, komponentja e energjisë, etj.).

KEK-u ka përdorur modelin tarifor me qëllim të përgatitjes së tarifave në një mënyrë që ne mendojmë se do t'i mundësojë kompanisë t'i mbulojë të Hyrat e Lejueshme në një formë të arsyeshme duke marrur parasysh kushtet afariste, financiare dhe operative me të cilat ajo ballafaqohet.

Më poshtë janë paraqitur sqarimet lidhur me strukturën tarifore, duke u përqendruar kryesisht në ndryshimet e dukshme nga struktura ekzistuese:

Grupi Tarifor 0 – 110 KV

Ngarkesa e fuqisë angazhuese e cila më parë gjatë vitit varionte sipas sezonës së caktuar, është thjeshtësuar në një nivel më të ulët prej 7.50 €/ KW për muaj. Ngarkesat energjetike janë rritur për të reflektuar komponenten e kërkesës më të ulët dhe reflektimin më se të duhur të kostove më të larta në rritje të importeve të energjisë elektrike gjatë dimrit.

Grupi Tarifor 1 – 35 KV

Ngarkesa e fuqisë angazhuese e cila më parë gjatë vitit varionte sipas sezonës, është thjeshtësuar deri në një nivel më të ulët prej 7.00 €/ KW për muaj. Ngarkesat e energjisë janë rritur për të reflektuar komponenten e kërkesës më të ulët dhe reflektimin më se të duhur të kostove më të larta në rritje të importeve të energjisë elektrike gjatë dimrit.

Grupi Tarifor 2 – 10 KV

Ngarkesa e fuqisë angazhuese e cila më parë gjatë vitit varionte sipas sezonave është thjeshtësuar në një nivel më të ulët prej 6.00 €/ KW për muaj. Ngarkesat e energjisë janë rritur për të reflektuar komponenten e kërkesës më të ulët dhe reflektimin më se të duhur të kostove më të larta në rritje të importeve të energjisë elektrike gjatë dimrit.

Grupi Tarifor 3 – Konsumatorët Komercial të Mëdhenj (0.4 KV)

Ngarkesa e fuqisë angazhuese e cila më parë gjatë vitit varionte sipas sezonave është thjeshtësuar në një nivel më të ulët prej 5.00 € për KW për muaj. Ngarkesat e energjisë janë rritur për të reflektuar komponenten e kërkesës më të ulët dhe reflektimin më se të duhur të kostove më të larta në rritje të importeve të energjisë elektrike gjatë dimrit.

Grupi Tarifor 4 – Konsumatorët Komercial të Vegjël (0.4 KV)

Këta konsumatorë nuk kanë njehësorë për fuqi angazhuese. Tarifa e tanishme përdorë konceptin e një fuqie angazhuese që bazohet në “të dhënat e futura” për energjinë elektrike të konsumuar gjatë periudhës së ngarkesës maksimale (pikut). Kjo ka shkaktuar huti te konsumatorët dhe tani, tarifat e propozuara eliminojnë ngarkesën për fuqi angazhuese dhe në vend të saj rrisin ngarkesën për energji elektrike gjatë periudhës së konsumit maksimal (pikut).

Grupi Tarifor 5 dhe 6 – Konsumatorët e Amvisisë

Këta konsumatorë nuk kanë njehsorë për fuqi angazhuese. Tarifa e tanishme përdorë konceptin e një fuqie angazhuese që bazohet në “të dhënat e futura” për energjinë elektrike të konsumuar gjatë periudhës së ngarkesës maksimale (pikut). Kjo ka shkaktuar huti te konsumatorët dhe tani, tarifat e propozuara eliminojnë ngarkesën për fuqi angazhuese e cila sillet mesatarisht 3.60 € në muaj për çdo konsumator.

Është futur një Ngarkesë për Konsumatorë, në harmoni me Metodologjinë Tarifore për të mbuluar kostot e leximit, faturimit, inkasimit dhe kostot tjera që lidhen me konsumatorë. Kjo është përcaktuar nga ana e ZRrE-s të jetë rreth 20 deri 24 euro në vit për secilin konsumator. KEK-u mendon se është me rëndësi që të mbulohet edhe një pjesë e kostove tjera fikse të tij në këtë Ngarkesë për Konsumatorë (ngjajshëm me komponenten e fuqisë angazhuese në tarifat ekzistuese). Prandaj, ne kemi përfshirë një shumë fikse prej 5 € në muaj si komponentë tarifore e cila mund t'i referohet një Ngarkese për një Njehsor me qëllim të mbulimit të një pjese të shpenzimeve fikse. Kjo do të ndihmonte gjithashtu që t'i bind

konsumatorët që mos të abuzojnë me bllok strukturën tarifore. Pjesa tjetër e kostove janë mbuluar në ngarkesën e energjisë elektrike.

KEK-u propozon që të vazhdohet me një strukturë prej 2 niveleve të konsumit por që nivelet e konsumit janë definuar si vijon:

0 – 600 kWh në muaj

Mbi 600 kWh në muaj

Meqë modeli i ZRrE ka përdorur strukturën me 3 nivelet të konsumit, derisa ne propozojmë një strukturë me 2 nivelet të konsumit, caktimin e çmimeve e kemi bërë për 2 nivelet të konsumit e para (e cila mbulon deri 600 kWh) me vlera të njëjta.

Tarifat e propozuara janë paraqitur në tabelë së bashku me një krahasim me tarifat ekzistuese.

KEK-u i propozon ZRrE këto tarifa. Në rast se ZRrE vendos të imponojë një strukturë tjetër tarifore, KEK-u do të kërkojë 60 – 90 ditë shtesë për implementimin e ndryshimeve në program dhe procedura për të futur në fuqi skemat e reja. Deri atëherë në fuqi do të jenë tarifat ekzistuese.



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

| Tariff Group | Voltage level of supply | Tariff elements | Unit | Time-of-day (a) | Previous | | KEK Proposal | |
|--|---|--|-------------------|-----------------|----------------------|------------------------|----------------------|------------------------|
| | | | | | High season | Low season | High season | Low season |
| | | | | | 1 October - 31 March | 1 April - 30 September | 1 October - 31 March | 1 April - 30 September |
| 0 | 110kV | Standing (customer) charge | €/customer/year | | | | 34.00 | |
| | | Standing (demand) charge | €/kW | | 1,150.00 | 895.00 | 750.00 | 750.00 |
| | | Active energy (P), of which: | €/kWh | High tariff | 2.68 | 2.11 | 4.25 | 1.75 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 1.34 | 1.09 | 2.00 | 1.40 |
| | | Reactive energy (Q) | €/kVArh | | 1.41 | 1.15 | | |
| 1 | 35kV | Standing (customer) charge | €/customer/year | | | | 30.00 | |
| | | Standing (demand) charge | €/kW | | 1,278.00 | 959.00 | 700.00 | 700.00 |
| | | Active energy (P), of which: | €/kWh | High tariff | 3.20 | 2.56 | 5.50 | 2.70 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 1.60 | 1.28 | 2.50 | 2.40 |
| | | Reactive energy (Q) | €/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 0.04 | 0.04 |
| 2 | 10kV | Standing (customer) charge | €/customer/year | | | | 34.00 | |
| | | Standing (demand) charge | €/kW | | 1,278.00 | 959.00 | 600.00 | 600.00 |
| | | Active energy (P), of which: | €/kWh | High tariff | 3.52 | 2.81 | 6.20 | 3.00 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 1.76 | 1.41 | 3.10 | 2.75 |
| | | Reactive energy (Q) | €/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 0.32 | 0.32 |
| 3 | 0.4kV Category I (large reactive power) | Standing (customer) charge | €/customer/year | | | | 29.00 | |
| | | Standing (demand) charge | €/kW | | 852.00 | 631.00 | 500.00 | 500.00 |
| | | Active energy (P), of which: | €/kWh | High tariff | 5.11 | 3.83 | 7.50 | 4.00 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 2.56 | 1.92 | 3.25 | 2.40 |
| | | Reactive energy (Q) | €/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 1.53 | 1.53 |
| 4 | 0.4kV Category II | Standing (customer) charge | €/customer/year | | | | 34.00 | |
| | | Standing (demand) charge | €/kW | | 253.00 | 189.00 | | |
| | | Active energy (P) | €/kWh | Single tariff | 7.57 | 5.68 | 9.73 | 6.23 |
| | | Active energy (P), of which: | €/kWh | High tariff | 9.47 | 6.94 | 11.05 | 6.35 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 5.05 | 3.79 | 7.14 | 6.01 |
| 5 | 0.4kV (domestic 2-rate meter) | Standing (customer) charge | €/customer /month | | | | 5.00 | |
| | | Standing (demand) charge of which: (b) | | | | | | |
| | | <800 kWh/month | €/kWh | | 144.00 | 115.00 | | |
| | | >800 kWh/month | €/kWh | | 192.00 | 144.00 | | |
| | | Active energy (P), for consumption: | | | | | | |
| | | <200kWh/month (First Block) of which: | €/kWh | High tariff | 4.80 | 3.83 | 4.20 | 3.10 |
| | | | €/kWh | Low tariff | 2.40 | 1.92 | 2.10 | 1.55 |
| | | 200-600 kWh/month (Second Block) of w | €/kWh | High tariff | 4.80 | 3.83 | 4.20 | 3.10 |
| | €/kWh | Low tariff | 2.40 | 1.92 | 2.10 | 1.55 | | |
| >600 kWh/month (Third Block) of which: | €/kWh | High tariff | 5.11 | 3.83 | 8.50 | 6.32 | | |
| | €/kWh | Low tariff | 2.56 | 1.92 | 4.25 | 3.17 | | |
| 6 | 0.4kV (domestic, 1-rate meter) | Standing (customer) charge | €/customer /month | | | | 5.00 | |
| | | Standing (demand) charge of which: (b) | | | | | | |
| | | <800 kWh/month | €/kWh | | 144.00 | 115.00 | | |
| | | >800 kWh/month | €/kWh | | 192.00 | 144.00 | | |
| | | Active energy (P), for consumption: | | | | | | |
| | | <200kWh/month (First Block) of which: | €/kWh | Single tariff | 3.99 | 3.20 | 2.99 | 2.11 |
| | | 200-600 kWh/month (Second Block) of w | €/kWh | Single tariff | 3.99 | 3.20 | 2.98 | 2.11 |
| | | >600 kWh/month (Third Block) of which: | €/kWh | Single tariff | 6.39 | 4.80 | 7.77 | 3.53 |
| 7 | 0.4kV (domestic unmetered) | Estimated consumption <400kWh/month | €/customer/month | | 20.00 | 20.00 | 20.00 | |
| | | Estimated consumption 400-800kWh/mor | €/customer/month | | 36.00 | 36.00 | 36.00 | |
| | | Estimated consumption >800kWh/month | €/customer/month | | 61.00 | 61.00 | 61.00 | |
| 8 | Public lighting | Standing (customer) charge | €/customer /month | | | | 34.00 | |
| | | >800 kWh/month | €/kWh | Single tariff | 8.21 | 6.31 | 7.82 | 7.82 |